



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

|                                |  |
|--------------------------------|--|
| <b>Datë/a:</b>                 | 17.06.2021   |
| <b>Referenc-ë:</b>             | 07-353/04-112660/21  |
| <b>Për/ Za/ To:</b>            | “Ikonë Studio”SH.P.K   |
| <b>Përmes/Preko/Through:</b>   | Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit  |
| <b>Nga/ Od/ From:</b>          | Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike<br>Kontrollloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit |
| <b>Tema/ Subjekat/Subject:</b> | Pëlqim   |

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-112660/21 me të cilën kërkohet që me datë 17 dhe 18 Qershor 2021 nga ora 12:00 deri në 05:00 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në Butovc , parkingu tek varrezat e qytetit (Dragodan) si dhe rruga e Veterikut nga Albi Mall deri tek rrethi i Stacionit të Autobusëve. .

Qëllimi i aktivitetit është xhirimi i një videoklipi.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe xhirimin me datë 17 dhe 18 Qershor 2021 në Butovc dhe parkingun e varrezave të Qytetit në (Dragodan).

Ndërsa rruga e Veterikut nga Albi Mall deri te rrethi i Stacionit të Autobusëve është nën menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.